



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 328/2019

?Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 30.05.2019 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: “Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e operatorit ekonomik “Pastrime Silvio” sh.p.k në procedurën e prokurimit me Nr.REF-09499-02-19-2019, me objekt: *“Shërbimi i mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbra në QSUT”, “Marrëveshje Kuadër”, me fond limit 4.813.300 lekë pa tvsh, zhvilluar ne daten 15.03.2019 nga autoriteti kontraktor Qendra Spitalore Universitare “Nene Tereza”.*

Ankimues: “Pastrime Silvio” sh.p.k
Rr. “Fatmir Haxhiu”, Pallati 2, Shk.10, Ap.76, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Qendra Spitalore Universitare “Nene Tereza”
Rruga e Dibres Nr. 372, Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim dhe pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 20.02.2019 është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit me Nr.REF-09499-02-19-2019, me objekt: “*Shërbimi i mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbra në QSUT*”, “*Marrëveshje Kuadër*”, me fond limit 4.813.300 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 15.03.2019 nga autoriteti kontraktor Qendra Spitalore Universitare “Nene Tereza”.

II.2. Në datën 26.03.2019 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht për klasifikimin përfundimtar të ofertave dhe ofertuesit e skualifikuar si më poshtë:

- | | |
|-----------------------------|------------------------------|
| 1. “Pastrime Silvio” sh.p.k | 3.885.100 lekë, skualifikuar |
| 2. “Kajmaku” sh.p.k | 4.751.100 lekë, skualifikuar |

Operatori ekonomik “Pastrime Silvio” sh.p.k është skualifikuar me argumentin se:

*1.Oferta refuzohet pasi operatori nuk ploteson kriterin teknik,Pika 2.3/Kreu II/pika 3, si me poshte:
Operatori ekonomik duhet te kete per periudhen Janar 2018 – Dhjetor 2018 drejtues teknik per kryerjen e sherbimeve objekt prokurimi me profesion Inxhinier Mjedisi/Agronom, i cili duhet te kete minimalisht 5 vjet eksperience pune, të vertetuar me kontraten e punes, diplomen.*

-Operatori ekonomik duhet te percaktoje drejtuesin teknik nepermjet nje deklarate me shkrim.

2.Gjithashtu operatori nuk ploteson Kapacitetin teknik (Pika 2.3/Kreu III, specifikisht Dokumentacioni per makinat e transportit duhet te shoqerohen edhe me : -Leje te transportit te Mallrave(e vlefshme ne kohen e zhvillimit te procedures)

II.3. Në datën 01.04.2019 operatori ekonomik “Pastrime Silvio” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar skualifikimin e tij në procedurën e prokurimit. Konkretisht pretendohet si më poshtë vijon:

“Nuk jemi dakort me arsyet e skualifikimit si më sipër, për këto arsye:

Për plotësimin e pikës 3, të Kreut II të Kapacitetit Teknik të Kriteve të Vecanta të Kualifikimit kemi dorëzuar: Deklaratën për Drejtuesin Teknik, Kontratë Pune, Diplomë, Certifikatë mbi Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, CV, Librezë Pune, Vërtetim nga Prefekti i Qarkut Berat, Vërtetim nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Berat.

Kriteri sipas të cilit: “Operatori ekonomik duhet te kete per periudhen Janar 2018 – Dhjetor 2018 drejtues teknik per kryerjen e sherbimeve objekt prokurimi me profesion Inxhinier Mjedis/Agronom, i cili duhet te kete minimalisht 5 vjet eksperience pune, të vertetuar me kontraten e punes, diplomen”, kërkon që të plotësohen në mënyrë kumulative 3 kushte: Kushti i parë, që Drejtuesi Teknik të jetë i punësuar pranë OE për periudhën janar 2018-dhjetor 2018. Kushti i dytë, që profesioni i Drejtuesit Teknik të jetë Inxhinier Mjedis ose Agronom dhe Kushti i tretë, që Drejtuesi Teknik të ketë një eksperiencë pune 5 vjecare. Pra, duhet të plotësohen në mënyrë kumulative këto 3 kushte që dokumentacioni të jetë i vlefshëm.

Kushti i parë, sipas të cilit Drejtuesi Teknik duhet të jetë i punësuar pranë OE për periudhën janar 2018-dhjetor 2018 plotësohet, pasi, sic vërtetohet nga kontrata e punës, librezja e punës dhe listpagesat, marrëdhënia e punës me Ing e Mjedisit ka filluar që në shtator të vitit 2017

Kushti i dytë, sipas të cilit profesioni i Drejtuesit Teknik duhet të jetë Inxhinier Mjedis apo Agronom plotësohet pasi, sic vërtetohet nga diploma, profesioni i Drejtuesit Teknik të përcaktuar është Inxhinier Mjedis.

Kushti i tretë sipas të cilit Drejtuesi Teknik duhet të ketë një eksperiencë pune 5-vjecare plotësohet, pasi në bazë të vërtetimeve të dorëzuara, vërtetohet një eksperiencë pune prej 6 vjet e 2 muaj, nga të cilët 1 vit e 11 muaj në Prefekturën e Qarkut Berat, 2 vjet e 9 muaj (maj 2015-janar 2018) pranë disa shoqërive private dhe 1 vit e gjashtë muaj (shtator 2017-shkurt 2019) pranë shoqërisë “Pastrime Silvio” sh.p.k Përsa më sipër, kjo arsye skualifikimi nuk qëndron dhe për këtë arsye duhet të shfuqizohet.

Ndërsa sa i takon arsyet së dytë të skualifikimit sipas të cilës: “2.Gjithashtu operatori nuk ploteson Kapacitetin teknik (Pika 2.3/Kreu III, specifikisht Dokumentacioni per makinat e transportit duhet te shoqerohen edhe me : -Leje te transportit te Mallrave(e vlefshme ne kohen e zhvillimit te procedures)”, për plotësimin e Kreut II, ku kërkohet:

Makinat e transportit te shoqerohen gjithashtu edhe me:

- *Leje te Transportit te Mallrave (te vlefshme në kohën e zhvillimit të procedurës)*
- *Leje qarkullimi,*
- *certifikaten e kontrollit teknik,*
- *leje drejtimi per drejtuesin e mjetit te transportit (patenta për të paktën 1 drejtues mjeti)*

- siguracionin e mjetit leshuar nga organet kompetente ne emer te shoqerise apo subjektit pronar te mjetit.

Në nenin 28 të udhëzimit nr.15, datë 24.07.2007 “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor” (i ndryshuar me udhëzimin nr.5, datë 17.05.2011) përcaktohet që “Kamionët me kapacitet transportues nën 1500 kg nuk certifikohen për transport mallrash brenda vendit” dhe duke u nisur nga ky fakt, vetëm autoboti duhet të shoqërohet me Leje Transporti.

Për autobotin e marrë me qira, i vitit të prodhimit 2006, të dorëzuar për plotësimin e këtij kriteri, është dorëzuar edhe Leja e Transportit, e vlefshme deri në vitin 2020 (dokumentat po i ridërgojmë bashkëngjitur)- Certifikata e Miratimit me nr. N3B-0599-02.

Pra kjo arsye skualifikimi nuk qëndron dhe duhet të shfuqizohet.”

II.5. Nëpërmjet shkresës Nr.1410/4 Prot., datë 08.04.2019, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimesit, duke pranuar pjesërisht ankesën lidhur me arsyen e dytë të skualifikimit të ankimesit për makinat e transportit.

Përsa i përket arsyes së parë të skualifikimit sipas të cilës: “operatori nuk ploteson kriterin teknik, Pika 2.3/Kreu II/pika 3, si me poshte:Operatori ekonomik duhet te kete per periudhen Janar 2018 – Dhjetor 2018 drejtues teknik per kryerjen e sherbimeve objekt prokurimi me profesion Inxhinier Mjedisi/Agronom, i cili duhet te kete minimalisht 5 vjet eksperience pune, të vertetuar me kontraten e punes, diplomen”, autoriteti kontraktor nuk i ka pranuar pretendimet e ankimesit me argumentat e mëposhtme:

“Në lidhje me këtë pretendim, nga verifikimi i kërkesave të autoritetit kontraktor në DST, dokumentacionit të administruar në SPE si dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezulton se:

Së pari, KSHA shqyrtoi kërkesat e bëra nga autoriteti kontraktor në DST për objektin e gjykimit, ku rezulton se nga AK, në seksionin 2.3 Për kapacitetin teknik, II. Kërkesat profesionale të personelit, pika 3, kërkohet:

“Operatori ekonomik duhet te kete per periudhen Janar 2018 – Dhjetor 2018 drejtues teknik per kryerjen e sherbimeve objekt prokurimi me profesion Inxhinier Mjedisi/Agronom, i cili duhet te kete minimalisht 5 vjet eksperience pune, të vertetuar me kontraten e punes, diplomen.

-Operatori ekonomik duhet te percaktoje drejtuesin teknik nepermjet nje deklarate me shkrim.”

Për plotësimin e kësaj pike rezulton se OE ankimes ka administruar në SPE dokumentacionin si më poshtë:

1. Deklaratë mbi Drejtuesin Teknik e datës 15.03.2019, ku përcaktohet se Drejtuesi Teknik në rastin e shpalljes fitues, do të jetë Inxhinierja e Mjedisit Zonja A. Gishti.
2. Kontratën Individuale të Punës me nr. 4263 Rep., 1518 Kol., datë 08.10.2018, e lidhur ndërmjet punëdhënësit “Pastrime Silvio” sh.p.k dhe punëmarrëse znj. A.Gishti.
3. Fotokopje e noterizuar e diplomës së Znj. A.G me nr. 759 Rep., datë 15.03.2018
4. Fotokopje e noterizuar e certifikatës me nr. 5053 prot., datë 22.06.2017 me identifikues 447, lëshuar nga Ministria e Mjedisit.
5. CV e znj. A.G
6. Librezë pune (faqja 2-3) në emër të znj. A.G., ku rezulton se kjo librezë është hapur me datë 01.09.2017 nga shoqëria “Pastrime Silvio” sh.p.k si dhe faqe (16-17) ku rezulton se pasqyrohet

vetëm punëdhënësi “Pastrime Silvio” sh.p.k, për datën e fillimit të punës 01 Shtator 2017 për pozicionin Drejtuese Teknike – Ing Mjedisi.

7. Vërtetim nr. 1109 prot., datë 14.05.2018 e Prefektit të Qarkut Berat ku vërteton se znj. A.G ka qënë e punësuar pranë këtij institucioni për periudhën 02.02.2006- 17.12.2007.
8. Vërtetim për bazën e vlerësuar me nr. 271 prot., datë 15.05.2018 e lëshuar nga DRSSH Berat për subjektin znj. A.G, në dy faqe.

Gjithashtu rezultojnë në SPE:

Listpagesa të konfirmuara të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore TA nga punësimi, të konfirmuara nga Tatimet për periudhën janar 2018-dhjetor 2018.

Nga verifikimi i dokumentacionit tekniko-ligjor dhe sa kërkohet në DST, KSHA konstaton se në mënyrë që të plotësohen kërkesat e seksionit 2.3 Për kapacitetin teknik, II. Kërkesat profesionale të personelit kryesor, pika 3 ku kërkohet: Operatori ekonomik duhet te kete per periudhen Janar 2018 – Dhjetor 2018 drejtues teknik per kryerjen e sherbimeve objekt prokurimi me profesion Inxhinier Mjedisi/Agronom, i cili duhet te kete minimalisht 5 vjet eksperience pune, të vërtetuar me kontraten e punes, diplomën, së pari., cdo OE duhet fillimisht të vërtetojë nëpërmjet dokumentacionit teknik e ligjor se, në përbërje të stafit, për periudhën janar 2018 – dhjetor 2018 ka drejtues teknik dhe më tej të vërtetojë se ky Drejtues Teknik ka minimalisht 5 vjet eksperiencë.

Përsa është argumentuar më sipër, KSHA në respektim të detyrimeve që burojnë nga dispozitat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, si dhe VKM nr. 914/2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, konkludon se i vetmi dokumentacion që ka paraqitur OE ankimes për të vërtetuar se ka drejtues teknik për periudhën janar 2018-dhjetor 2018 është kontrata e sipërcituar e punës me nr.4263 Rep, 1518 Kol., datë 08.10.2018, e lidhur ndërmjet punëmarrësit “Pastrime Silvio” sh.p.k dhe punëmarrëses znj. A.G, ku referuar nenit 3 të kësaj kontrate “Puna që do të kryhet” rezulton se punëmarrësi është kontraktuar në pozicionin Drejtues Teknik me profesion Inxhinier Mjedisi.

Neni 2 “Afati i kontratës” rezulton se, citohet se: “Kontrata e punës lidhet për një afat kohor 2-vjecar dhe kjo marrëdhënie ka filluar që me datë 01.09.2017 dhe përfundon më 31.08.2019, ndërkohë që sic pasqyrohet më sipër, kjo kontratë është lidhur para noterit me datë 08.10.2018.

Në këtë këndvështrim KSHA sqaron se një marrëdhënie pune rregullohet kryesisht nëpërmjet dy formave të parashikuara në Kodin e Punës së RSH, me anë të kontratës kolektive, si dhe atë individuale që ndodhemi edhe në rastin objekt shqyrtimi. Përsa i përket këtij rregullimi, në mënyrë që të formalizohet marrëdhënia e punës si dhe palët të garantojnë mbrojtjen e nevojshme ligjore, legjislatori normon dispozitat ligjore dhe kuadrin e nevojshëm ligjor që rregullojnë këtë fushë të marrëdhënieve të punës, ku kuptimi klasik i kontratës parashikohet në Kodin Civil, neni 659 (e vijues) ku citohet se: Kontrata është veprimi juridik me anë të së cilës një ose disa palë krijojnë, ndryshojnë ose shuajnë një marrëdhënie juridike. Ndërsa në marrëdhënien konkrete të punës, parashikohet në Kodin e Punës të RSH, Kreu V, A. Përkufizim, Kontrata e Punës, Neni 12 ku citohet se: “Kontrata e Punës është një marrëveshje ndërmjet punëmarrësit dhe punëdhënësit, që rregullon marrëdhëniet e punës dhe përmban të drejtat dhe detyrimet e palëve. Në kontratën e punës punëmarrësi merr përsipër të ofrojë punën ose shërbimin e vet për një periudhë të caktuar ose të pacaktuar kohe, në kuadër të organizimit dhe të urdhërave të një personi tjetër, të quajtur punëdhënës, i cili merr përsipër të paguajë një shpërblim [...]; Më tej, në Kapitullin B. Lindja e Marrëdhënieve të Punës, Forma e Kontratës së Punës, Neni 21, pika 1, kërkohet që: Kontrata

e punës lidhet në formë të shkruar. Ajo mund të ndryshohet me shkrim, nëse palët bien dakort për ta bërë këtë, ndërsa në pikën 4, po të këtij neni shprehimisht citohet që: Për raste të vecanta dhe të justifikueshme, nëse kontrata nuk lidhet sipas pikave 1 dhe 3 të këtij neni, punëdhënësi është i detyruar ta lidhë atë brenda 7 ditëve nga dita e punësimit.

Pra sic rezulton nga argumentimet si dhe parashikimet e dispozitave ligjore në fuqi, të cituara më sipër, afati i pasqyruar në nenin 2 “Afati i Kontratës” në të cilën rezulton të citohet se: “Kontrata e punës lidhet për një afat kohor 2-vjecar dhe kjo marrëdhënie ka filluar që me datë 01.09.2017 dhe përfundon më 31.08.2019, nuk mund të sjellë efekte ligjore, për aq kohë sa legjislatori e ka normuar afatin brenda të cilës duhet të formalizohet kontrata e punës nga momenti i lidhjes së marrëdhënies së punës, dhe ai afat, edhe për raste të vecanta dhe të justifikueshme, është maksimumi 7 ditë nga dita e punësimit, dhe në rastin tonë, palët kanë formalizuar një kontratë pune mbas 1 viti e 1 muaji, cka bie në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, duke sjellë pavlefshmërinë e pjesshme të kësaj kontratë, për periudhën nga data 01.09.2017 deri në momentin e nënshkrimit nga palët para noterit (duke qënë se nuk është parashikuar datë hyrje në fuqi të kësaj kontrate), dhe në këtë kontekst, si dhe nga dokumentacioni i administruar në SPE, operatori ekonomik nuk e plotëson kërkesën e bërë nga AK ku të ketë Drejtues Teknik për periudhën janar 2018- dhjetor 2018 për kryerjen e shërbimeve objekt prokurimi me profesion inxhinier mjedisi/agronom.

Gjithashtu KSHA konstaton se paga që referohet në këtë kontratë, sipas dokumentacionit të administruar në SPE, referuar nenit 8 të Kontratës, “Pagesa” ku citohet se: “paga e punës sipas konsideratave të plota për punën e kryer nga e punësuarja, konform kushteve të kontratës, shoqëria “Pastrime Silvio” sh.p.k do të paguajë të punësuarën 24.000 lekë bruto në muaj. Paga individuale për punonjësën që është palë në kontratë [...] është në shkelje të parashikimeve të bera në VKM nr. 809, datë 26.12.2018 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, pika 1 ku përcaktohet se: “Paga bazë minimale mujore, për punonjësën në shkallë vendi, që është e detyrueshme të zbatohet nga cdo person juridik a fizik, vendas ose i huaj, të jetë 26.000 lekë.”

Përsa i përket eksperiencës së kërkuar nga AK, referuar dokumentacionit të administruar nga OE “Vërtetim për bazën e vlerësuar me nr., 271 prot., datë 15.05.2018, lëshuar nga DRSSH Berat” për subjektin znj.A.G, e administruar në dy faqe, në të cilën rezulton se OE synon të përmbushë kriterin e kërkuar në DST për eksperiencën 5 vjecare të Drejtuesit Tekni, rezulton se ky dokument i administruar në dy faqe, nuk përmban elementët e kërkuar për aktet e lëshuara nga Institucionet Shtetërore, pasi dokumentacioni nuk përmban vulë lidhëse, apo vulë sekretarie dhe nënshkrimi në të dyja faqet, që të vërtetojë se ky dokument në tërësi është lëshuar nga DRSSH Berat, dhe qofte faqja e parë, qoftë faqja e dytë, janë në vazhdimësi të njëra-tjetrës dhe të garantohet që nuk ka ndërhyrje të mëvonshme në këtë dokument. Kjo vërtetohet/garantohet me nënshkrimin në secilën faqe, duke e shoqëruar me vulë sekretarie, apo minimalisht me vulën lidhëse, e cila lidh faqen e parë me faqen e dytë dhe e cila bën që të plotësohen elementët e nevojshëm që akti administrativ të konsiderohet si i vlefshëm dhe për pasojë të plotësojë kërkesat e parashikuara në nenin 99 “Kërkesat e formës së aktit administrativ të shkruar në letër ose elektronike” të Kodit të Procedurave Administrative, pika 3, ku kërkohet që: Nëse nuk parashikohet ndryshe nga ligji, akti administrativ i shkruar në letër, përmban nënshkrimin, emrin dhe mbiemrin e shkruar të nëpunësit përgjegjës, apo përkatësisht të kryetarit dhe të sekretarit të organit kolegjial, dhe pika 4 ku kërkohet që: Akti administrativ elektronik nënshkruhet në mënyrë elektronike në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në këto raste, kërkesat e pikës 3 të këtij neni, zëvendësohen me

nënshkrimin elektronik të organit publik, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Sjellim në vëmendje që dokumenti që vërteton pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për individin, lëshohet edhe nga platforma e-albania me vulë elektronike, në zbatim të VKM nr. 495, datë 13.09.2017 “Për miratimin e rregullave të përfitimit të shërbimeve publike elektronike”, dhe fakti që OE paraqet një dokument shkresor të cilit i mungon vula lidhëse si element i nevojshëm që garanton vlefshmërinë e aktit administrativ në tërësi, bën që faqja e parë e këtij akti (pasi faqja e dytë përmban të gjitha elementët e vlefshërisë së aktit) të jetë e pavlefshme dhe të mos meret në konsideratë, kjo referuar nenit 108 të Kodit të Procedurave Administrative (Akti administrativ absolutisht i pavlefshëm) ku citohet që: Akti administrativ është absolutisht i pavlefshëm në rastet e mëposhtme: gërma a) kur vjen në kundërshtim të hapur dhe flagrant më një dipozitë urdhëruese të këtij Kodi dhe legjislacionit në fuqi lidhur me: iii) formën ose element të tjerë të detyrueshëm të aktit (i njëjti qëndrim është mbajtur nga KPP me vendimin KPP 162/2018, datë 26.03.2018, paragrafi III.2.5); Gjithashtu OE nuk e përmbush këtë kriter (eksperiencën prej 5 viteve punë të drejtuesit teknik) me dokumentacionin ligjor që të vërtetojë përmbushjen e kriterëve të kërkuara në DST, dhe referuar legjislacionit që rregullon fushën e prokurimeve, vlerësimi i KVO-së është i drejtë [...]”

II.6. Në datën 16.04.2019 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt si edhe në autoritetin kontraktor.

II.7. Në datën 30.04.2019 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 699/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 1410/8 prot., datë 25.04.2019, bashkëngjitur informacioni e dokumentacioni mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe trajtimin e ankesës.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “Pastrime Silvio” sh.p.k “Oferta refuzohet pasi operatori nuk plotëson kriterin teknik, Pika 2.3/Kreu II/pika 3, si me poshte: Operatori ekonomik duhet të ketë për periudhën Janar 2018 – Dhjetor 2018 drejtues teknik për kryerjen e shërbimeve objekt prokurimi me profesion Inxhinier Mjedis/Agronom, i cili duhet të ketë minimalisht 5 vjet eksperience pune, të vertetuar me kontratën e punës, diplomën. -Operatori ekonomik duhet të percaktojë drejtuesin teknik nepermjet nje deklarate me shkrim”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, “Kërkesat profesionale të personelit kryesor”, pika 3, të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi, është parashikuar plotësimi i kërkesës si vijon:

“Operatori ekonomik duhet te kete per periudhen Janar 2018 – Dhjetor 2018 drejtues teknik per kryerjen e sherbimeve objekt prokurimi me profesion Inxhinier Mjedis/Agronom, i cili duhet te kete minimalisht 5 vjet eksperience pune, te vertetuar me kontraten e punes, diplomen.

-Operatori ekonomik duhet te percaktoje drejtuesin teknik nepermjet nje deklarate me shkrim.”

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik “Pastrime Silvio” sh.p.k. në përmbushje të kriterit të mësipërm, rezulton se ky i fundit ka paraqitur dokumentacion si më poshtë vijon:

- 1. Deklaratë mbi Drejtuesin Teknik e datës 15.03.2019, ku përcaktohet se Drejtuesi Teknik për procedurën e prokurimit me objekt: “Shërbimi i mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbra në QSUT”, do të jetë Inxhinierja e Mjedisit Zonja A. Gishti.*
- 2. Kontratën Individuale të Punës me Nr. 4263 Rep., Nr.1518 Kol., datë 08.10.2018, e lidhur ndërmjet punëdhënësit “Pastrime Silvio” sh.p.k dhe punëmarrëses znj. A.Gishti, në prani të noterit.*
- 3. Fotokopje e noterizuar e diplomës së Znj. A.G nga Universiteti Politeknik i Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, Dega “Mjedis”.*
- 4. Fotokopje e noterizuar e certifikatës me nr. 5053 prot., datë 22.06.2017 me identifikues 447, lëshuar nga Ministria e Mjedisit për znj. A.G, me përmbajtjen: “Certifikohet për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis, për të kryer auditimin mjedisor, për hartimin e ekspertizave për problem mjedisore dhe thirrjen si ekspert për të vlerësuar një raport të vlerësimit të ndikimit në mjedis ose rezultatet e një auditimi”.*
- 5. CV e znj. A.G*
- 6. Librezë pune në emër të znj. A.G, e hapur me datë 01.09.2017 nga shoqëria “Pastrime Silvio” sh.p.k., faqet 2-3 dhe 16-17. Rezulton se pasqyrohet në të vetëm punëdhënësi “Pastrime Silvio” sh.p.k, për datën e fillimit të punës 01 Shtator 2017 për pozicionin Drejtuese Teknike – Ing Mjedis.*
- 7. Vërtetim nr. 1109 prot., datë 14.05.2018 e Prefektit të Qarkut Berat ku vërteton se znj. A.G ka qënë e punësuar pranë këtij institucioni për periudhën 02.02.2006- 17.12.2007.*
- 8. Vërtetim për bazën e vlerësuar me nr. 271 prot., datë 15.05.2018 e lëshuar nga DRSSH Berat për znj. A.G, në dy faqe.*
- 9. Listpagesa të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore TA nga punësimi, të konfirmuara nga Administrata Tatimore, Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë për periudhën janar 2018-dhjetor 2018.*

III.1.3. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”*

III.1.4. Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*

III.1.5. Në nenin 28, pika 5, gërma “b” dhe “c”, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, përcaktohet: *“Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose [...]”*

III.1.6. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme, në mbështetje edhe të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.

III.1.7. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar që *operatori ekonomik duhet të ketë për periudhën Janar 2018 – Dhjetor 2018 drejtues teknik për kryerjen e shërbimeve objekt prokurimi me profesion Inxhinier Mjedisi/Agronom, i cili duhet të ketë minimalisht 5 vjet eksperience pune, të vërtetuar me kontratën e punës, diplomën. Gjithashtu operatori ekonomik duhet të përcaktojë drejtuesin teknik nëpërmjet një deklaratë me shkrim. Pra drejtuesi teknik me profesion Inxhinier Mjedisi/Agronom, i cili deklarohet nga ofertuesi për procedurën e prokurimit, duhet të jetë punësuar pranë shoqërisë për periudhën janar 2018-dhjetor 2018. Dokumentacioni i nevojshëm i gjykuar nga AK se duhet paraqitur nga ofertuesi, është deklarata e subjektit, kontrata e punës dhe diploma e drejtuesit teknik të deklaruar për procedurën e prokurimit.*

Nga verifikimi i ofertës së shoqërisë “Pastrime Silvio” sh.p.k rezulton se është paraqitur deklarata e administratorit të shoqërisë ankimuese mbi Drejtuesin Teknik për procedurën e prokurimit objekt ankimimi, ku deklarohet si Drejtues Teknik Znj. A.G.

Për të vërtetuar kërkesën e autoritetit kontraktor që operatori ekonomik duhet të ketë për periudhën Janar 2018 – Dhjetor 2018 drejtues teknik, shoqëria “Pastrime Silvio” sh.p.k ka paraqitur: Listpagesat e shoqërisë për këtë periudhë, ku punonjësi A.G rezulton pranë kësaj shoqërie për të gjithë periudhën e kërkuar. Gjithashtu është paraqitur librezja e punës e punonjësit në fjalë, për pozicionin Drejtues Teknik – Ing Mjedisi, që vërteton punësimin e tij pranë shoqërisë ankimuese e cila përfshin edhe periudhën e

parashikuar në dokumentat e tenderi, pra data e fillimit të punës është 01 Shtator 2017 e në vazhdimësi. Përveç dy dokumentave të sipërcituar është paraqitur edhe Kontrata e punës të lidhur para noterit, ndërmjet punëdhënësit “Pastrime Silvio” sh.p.k dhe punëmarrësit Znj.A.G, datë 08.10.2018, sipas të cilës kjo kontratë ka filluar në datën 01.09.2017 dhe përfundon më 31.08.2019. Pra sipas dokumentacionit të paraqitur vërtetohet kushti i autoritetit kontraktor për periudhën e punësimit të DT pranë shoqërisë.

Për të vërtetuar kërkesën e autoritetit kontraktor që Drejtuesi Teknik duhet të jetë me profesion Inxhinier Mjedis/Agronom, shoqëria “Pastrime Silvio” sh.p.k ka paraqitur për Znj. A.G, dokumentacionin si vijon: Fotokopje të noterizuar të diplomës së Znj. A.G lëshuar nga Universiteti Politeknik i Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, Dega “Mjedis”; Fotokopje e noterizuar e certifikatës me nr. 5053 prot., datë 22.06.2017 me identifikues 447, lëshuar nga Ministria e Mjedisit për znj. A.G, me përmbajtjen: *“Certifikohet për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis, për të kryer auditimin mjedisor, për hartimin e ekspertizave për problem mjedisore dhe thirrjen si ekspert për të vlerësuar një raport të vlerësimit të ndikimit në mjedis ose rezultatet e një auditimi”*.

Përsa i përket kushtit të parashikuar nga autoriteti kontraktor që *Drejtuesi Teknik duhet të ketë minimalisht 5 vjet eksperience pune* rezulton se shoqëria “Pastrime Silvio” sh.p.k ka paraqitur CV e znj. A.G, ku rezulton se eksperiencia e saj e tejkalon kërkesën e autoritetit kontraktor. Gjithashtu është paraqitur Vërtetimi nr. 1109 prot., datë 14.05.2018 e Prefektit të Qarkut Berat ku vërteton se znj. A.G ka qënë e punësuar pranë këtij institucioni për periudhën 02.02.2006-17.12.2007 si dhe Vërtetimi për bazën e vlerësuar me nr. 271 prot., datë 15.05.2018, e lëshuar nga DRSSH Berat për znj. A.G, në dy faqe, ku jepet informacion për periudhën e punësimit të saj, mbi dy vjet, sipas të dhënave të sistemit informatik të pagesës së kontributeve mujore mbi bazën e pagës bruto. Pra sipas dokumentacionit të paraqitur vërtetohet eksperiencia 5 vjecare e znj.A.G.

III.1.8. Përsa i përket pretendimeve të autoritetit kontraktor për kontratën e punës, në Nenin 21 pika 1 të Ligjit Nr. 7961 dt.12.07.1995 “Kodi i Punës i RSH-së”, i ndryshuar, parashikohet se *“Kontrata e punës mund të lidhet dhe ndryshohet me gojë ose me shkrim. Ajo mund të ndryshohet vetëm në marrëveshje midis palëve. Çdo ndryshim i kontratës së shkruar, në dëm të punëmarrësit, duhet të përfundohet me shkrim”*. Gjithashtu në pikën 4 të po këtij neni parashikohet se *“Kur kontrata e punës lidhet me gojë, punëdhënësi është i detyruar që, brenda 30 ditëve nga data e lidhjes së kontratës, të hartojë me shkrim dokumentin përkatës, të nënshkruar prej tij dhe punëmarrësit, ku të përfshihen sidomos elementet e parashikuara në pikën 3 të këtij neni. Moshartimi i këtij dokumenti me shkrim nuk cenon vlefshmërinë e kontratës, por sjell vetëm përgjegjësinë e punëdhënësit, sipas nenit 202 pika 2 të këtij Kodi”*.

Sa më sipër, kontrata e punës është një marrëdhënie e krijuar ndërmjet palëve, me vullnetin e tyre të lirë, për realizimin e funksioneve të tyre. Kontrata e lidhur ndërmjet palëve është një veprim juridik, që referuar Kodit Civil, është *“shfaqja e ligjshme e vullnetit të personit fizik ose juridik, që synon të krijojë, të ndryshojë ose të shuajë të drejta ose detyrime civile”*. Kontrata e lidhur mes palëve është një veprimtari apo marrëdhënie e brendshme, e cila mund të jetë edhe e ndryshueshme në kohë.

Për autoritetin kontraktor është e rëndësishme që në momentin e zhvillimit të procedurës së prokurimit, operatori ekonomik të vërtetojë se disponon kapacitete në lidhje me stafin e kërkuar, duke realizuar edhe qëllimin e vendosjes së këtyre kriterëve, për të kualifikuar një shoqëri që plotëson të gjitha kriteret dhe kërkesat e autoritetit kontraktor. Konkretisht, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme që operatori ekonomik të ketë paraqitur dokumentacion në lidhje Drejtuesin Teknik sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentat e tenderit, i cili është i vlefshëm në kohën e kryerjes së procedurës.

Lidhur me pretendimin e autoritetit kontraktotr se *dokumenti i DRSSH Berat administruar në dy faqe, nuk përmban elementët e kërkuar për aktet e lëshuara nga Institucionet Shtetërore, pasi dokumentacioni nuk përmban vulë lidhëse, apo vulë sekretarie dhe nënshkrimi në të dyja faqet, që të vërtetojë se ky dokument në tërësi është lëshuar nga DRSSH Berat, dhe qofte faqja e parë, qoftë faqja e dytë, janë në vazhdimësi të njëra-tjetrës dhe të garantohet që nuk ka ndërhyrje të mëvonshme në këtë dokument*, nga shqyrtimi i dokumentit në fjalë rezultojnë se shkresa “Vërtetim për bazën e vlerësuar”, me nr. 271 prot., datë 15.05.2018 është lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Berat dhe përmban të dhënat e sistemit informatik të pagesës së kontributeve mujore në emër të znj. A.G. Ky dokument jep informacion në dy faqe, me numër faqesh në vazhdimësi, rezultojnë i firmosur dhe vulosur, përmban siglën e institucionit që e ka lëshuar, si dhe në fund të cdo faqeje ka informacionin mbi adresën e institucionit, nr telefoni, email etj, që garantojnë vërtetësinë e tij. Aktet e dala nga organet shtetërore kanë vlerën e provës kundrejt të gjitha institucioneve që ju drejtohen, por për të pasur këtë lloj cilësie ato duhet të përmbajnë të gjithë elementët thelbësore që i bejnë ato të vlefshme si nga ana formale dhe ajo materiale. Në rastin konkret shkresa e lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Berat formalisht i përmban të gjithë elementët përkatës të një shkrese zyrtare. Megjithatë, nëse autoriteti kontraktor ka dyshime për saktësinë e dokumentit në fjalë, mbështetur në rregullat e prokurimit publik mund të bëjë verifikimet përkatëse pranë institucionit D.R.S.Sh. Berat.

Lidhur me pretendimin e autoritetit kontraktor për sa i përket pagesës së drejtuesit teknik, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave ka dalë jashtë tagrit të saj duke konstatuar dhe shtuar arsye skualifikimi, në tejkalim të kompetencave që parashikon ligji.

Arsyet e reja të skualifikimit dhënë nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, në tejkalim të kompetencave që u jep shprehimisht nëneni 78 i VKM nr.914 datë 29.12.2014, nuk sjellin asnjë pasojë mbi operatorin ekonomik ankimues e si të tilla nuk merren në shqyrtim nga KPP.

Për sa më sipër, Komisioni gjykon se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Pastrime Silvio” sh.p.k në sistemin e prokurimeve elektronike është në përputhje me kriteret e vecanta të kualifikimit të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit në lidhje me Drejtuesin Teknik.

Pretendimi i shoqërisë “Pastrime Silvio” sh.p.k qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, me shumicë votash

Vendos

1. Të pranohet ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Pastrime Silvio” sh.p.k për procedurën e prokurimit me Nr.REF-09499-02-19-2019, me objekt: “*Shërbimi i mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbra në QSUT*”, “*Marrëveshje Kuadër*”, me fond limit 4.813.300 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 15.03.2019 nga autoriteti kontraktor Qendra Spitalore Universitare “Nene Tereza”.

2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Pastrime Silvio” sh.p.k, duke e kualifikuar atë.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Pastrime Silvio” shpk
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 699 Protokolli,

Datë 16.04.2019

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Enkeleda Bega	Vilma Zhupaj	Lindita Skeja	Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha